

NJOFTIM
Nr. 705, datë 23.5.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 23.7.2010 "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit , të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009", si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë Arë	Gjiri i Lalzit, Durrës	1 452 700	0	1 452 700	745	0	18.6.2019	10:00	DDPP

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë Arë	Gjiri i Lalzit, Durrës	1 452 700	0	1 452 700	1515	0	18.6.2019	11:00	DDPP

3. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë Arë	Sauk, Tiranë	17 092 400	0	17 092 400	13 000	0	18.6.2019	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhet pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al